edhe pasojat pas zgjidhjes së martesës. Edhe në atë gjykim rezulton të ketë qenë paditëse shtetësja Florie Çoçka.

Në këto kushte, nga ana e paditëses Florie Çoçka është kërkuar heqja dorë nga ky gjykim dhe pushimi i tij.

Duke shqyrtuar kërkesën e palës paditëse për heqjen dorë nga gjykimi dhe pushimin e tij, gjykata çmon se jemi në kushtet e nenit 201 të K.Pr.Civile, në të cilin parashikohet *"1.Paditësi në çdo fazë të gjykimit në shkallë të parë, mund të heqë dorë nga gjykimi i padisë. Heqja dorë ka efekt nëse i padituri e pranon atë. Megjithatë, pranimi i të paditurit nuk është i nevojshëm nëse ai, në kohën kur paditësi paraqet kërkesën për heqje dorë nga gjykimi, nuk ka dorëzuar ende deklaratën e mbrojtjes për themelin e çështjes. 2.Gjykata mund të vendosë pushimin e gjykimit edhe nëse mospranimi i të paditurit nuk ka shkak të ligjshem".*

Kurse në nenin 299 përcaktohet se: *"Gjykata vendos pushimin e gjykimit kur: ...b) paditësi heq dorë nga gjykimi i padisë"*

Në këto rrethana, gjykata referuar kërkesës për heqje dorë nga gjykimi, çmon se në këtë rast duhet të vendosë pushimin e gjykimit të çështjes për këtë shkak.

Në lidhje me shpenzimet gjyqësore, ato përbëhen nga taksa mbi aktet në masën 3000 lekë, të cilat në kushtet e pushimit të gjykimit duhet t'i ngarkohen paditësit.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 179/2 dhe 299/ç të K.Pr.Civile

V E N D O S I

1. Pushimin e gjykimit të çështjes civile me palë:
   Paditëse: Florie Çoçka
   I paditur: Eraldi Çoçka
   Objekti: Zgjidhje martese etj
   për shkak për shkak se paditësja hoqi dorë nga gjykimi.

2. Shpenzimet gjyqësore në masën 3000 lekë mbeten në ngarkim të paditëses sikurse janë bërë.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm brenda 5 ditëve nga e nesërmja e komunikimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Korçë, sot në datë 16.04.2025 ora 12 :04

SEKRETARE
FA

GJYQTARE
LULJETA KOLE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
K O R Ç Ë

Nr.Regj. 21001-00354-41-2025 (1387)
Datë Regjistrimi 27.03.2025

Nr.Vendimi 41-2025-1268 (321)
Datë Vendimi 16.04.2025

V E N D I M
"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, e përberë prej:

Gjyqtare Luljeta KOLE

Asistuar nga sekretare Fatjona Xhuti, në Korçë, në datë 16.04.2025, mori në shqyrtim në seance gjyqësore me dyer të hapura çështjen civile që i përket:

PADITËSE: **Florie Çoçka,** e bija e Qani dhe Salije, e datëlindjes 20.03.1996, lindur dhe banues në Laktesh, Pogradec.

I PADITUR: **Eraldi Çoçka,** i biri i Zybri dhe i Marjeta, i datëlindjes 15.08.1993, lindur dhe banues në Podgorie, Maliq.

OBJEKTI: Zgjidhje martese dhe rregullimi i pasojave të zgjidhjes së martesës

Baza ligjore: Neni 132 e vijues i Kodit të Familjes.

Në gjykim e sipër të zhvilluar në prani të paditëses dhe në mungesë të të padituri, Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e paditëses për pushimin e gjykimit,

V Ë R E N

Paditësja Florie Çoçka ka paraqitur në gjykatë kërkesëpadi kundër të padituri Eraldi Çoçka duke kërkuar zgjidhjen e martesës ligjore të lidhur ndërmjet palëve.

Pas regjistrimit të çështjes, gjykata fillimisht bazuar në nenin 134 të Kodit të Familjes njoftoi palët për seancën pajtimore, duke i komunikuar të padituri edhe kopje të kërkesëpadisë dhe provave bashkëlidhur të paraqitura nga paditësja.

Në seancën e sotme datë 16.04.2025 u paraqit vetëm paditësja, ndërsa për të padituri njoftimi i dërguar në adresën e shënuar në kërkesëpadi u kthye me shënimin "Refuzuar".

Në këtë seancë nga ana e gjykatës i është bërë me dije paditëses se sipas konstatimit të sekretarisë regjistruese, me vendimin nr.558, datë 29.05.2024 Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ka vendosur zgjidhjen e martesës midis po të njëjtave palë, duke rregulluar